



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional

STANDARDI I PROFESIONIT

METALPUNUES – Niveli i 4-të, KKK

Sektori: Makineri

Kodi: (ISCO 08), 7223 Punëtorët për vendosjen dhe operimin e mjeteve të makinave për punimin e metalit sipas (KPK 08, Prishtinë 2016)

Versioni në gjuhen Angleze (7223 Metal Working Machine Tool Setters and Operator), ISCO 08 ILO

Data e aprovimit:

Ky standard i profesionit është zhvilluar me mbështetjen e Projektit KSV/020 "Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë", i menaxhuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT.

Referencat:

1. SIHTASUTUS – Kutsekoda, ESF program "Kutsete süsteemi arendamine" KUTSESTANDARD, Metallilõikepinkidel töötaja, tase 4

Viide Ametite Klassifikaatorile (ISCO 08)/ 7223 Metallitöötlustpinkide seadistajad ja operaatorid
Kutsestandardi tähis kutseregistris 10-16092014-1.2/5k

Viide Euroopa kvalifikatsiooniraamistikule (EQF)/4

2. KUTSESTANDARD Keevitaja, tase 4 = Viide Ametite Klassifikaatorile (ISCO 08) / 7212

Keevitajad ja leeklõikajad

Kutsestandardi tähis kutseregistris / 10-16092014-1.5/6k

3. STANDARD KVALIFIKACIJE

Naziv kvalifikacije: Bravar – zavarivač (axhustator – saldues)

Sektor - područje rada: Mašinstvo i obrada metala

Nivo kvalifikacije: III, "Sl. glasnik RS - Prosvetni glasnik", br. 6/2014

4. Fabrication mécanique La coupe des métaux

Année, 2004-2005, Autori Philippe DEPEYRE

5. <http://www.npk.si/katalog.php?katalogid=86881701> (Sloveni)

6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
STANDARDI PROFESIONAL / METALPUNUESI / Sektori: Makineri

Vërejtje: Ky standard profesioni sipas klasifikimit të profesioneve në Kosovë ISCO 08, lidhet edhe me disa profesione të klasifikuara diku tjetër si:

- **Kodi: (ISCO 08), 7212** Salduesit dhe prerësit me flakë, Versioni në gjuhën Angleze (7212 Welders and Flame Cutters), ISCO 08, ILO

Ekipi për zhvillimin e Standardit të Profesionit Metalpunues

Moderator: Ramë Likaj

Koordinatorë i ekipit: Afrim Gjellaj, Prof. Ass. Dr. inxh. dipl. i Inxhinierisë Mekanike

Anëtarët e grupit zhvillues: Binak Gerguri, inxh. dipl. i Inxhinierisë Mekanike
Skënder Berisha, inxh. dipl. i Inxhinierisë Mekanike

DRAFT

Profesioni: Metalpunues, niveli i 4 KKK

Përshkrimi i profesionit:

Standardi i profesionit është dokument që përshkruan kërkesat dhe kompetencat e kërkuara për këtë nivel, si tërësi të njohurive, shkathtësive dhe shprehive/qëndrimeve të nevojshme për të kryer me sukses detyrat e punës për profesione të caktuara.

Standardi i profesionit për Metalpunues, niveli i 4-të, sipas KKK është bazë për zhvillimin e kurrikulës në fushën e teknologjisë së përpunimit të metaleve me prerje, me saldim, punime axhusterike dhe vlerësimin e kompetencave profesionale të nxënësve.

Metalpunuesi – Standardi i profesionit për Metalpunues përfshinë grup profesionesh si: Axhustator, Saldues, Tornitor, Frezues, dhe operues për lakimin e llamarinave (formësimin) në makina CNC.

Metalpunuesi është fushë e teknologjisë e cila merret me përpunimin e pjesëve makinerike në makina metalprerëse duke përzgjedhur gjysmëfabrikatet, saldimin (me hark elektrik, me gaz dhe elektrozotizim), punime axhusterike (konstruktionet metalike-axhusterike), me punime lakimi (formësim) të llamarinave në makinat CNC, respektivisht hartimin e dokumentacionit teknologjik, përzgjedhjen e teknologjisë për përpunim, matjen dhe kontrollin e produkteve. Me të përfunduar shkollimin kandidati do të ketë këto njohuri, aftësi të përgjithshme dhe profesionale, aftësi intelektuale dhe të transferueshme.

I diplomuari në profesionin e metalpunuesit niveli i 4-të, kryesisht realizon kompetenca profesionale – funksione si në vijim:

- Planifikimi, përgatitja dhe organizimi i punimeve axhusterike – saldim,
- Punimi i pjesëve të konstrukcioneve metalike me përpunim mekanik
- Bashkimi (mbërthimi) i pjesëve të konstrukcioneve metalike me lidhje të ndashme dhe të pandashme
- Punimi dhe montimi i konstrukcioneve metalike dhe pajisjeve të procesit
- Kontrolli i cilësisë të punimeve axhusterike sipas udhëzimeve dhe normativave
- Saldimi me hark elektrik (HED, MIG, MAG, TIG), me elektrozotizim dhe me gaz
- Përpunimi i pjesëve makinerike në makina tornuese konvencionale
- Përpunimi i pjesëve makinerike në makina frezuese konvencionale
- Përpunimi i pjesëve makinerike në makina shpuese konvencionale
- Preja dhe formësimi i llamarinave me makinat CNC
- Kontrollimi i cilësisë të punës gjatë saldimit, përpunimit mekanik dhe përpunimit me prerje
- Respektim i masave mbrojtëse dhe të sigurisë në vendin e punës

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Zbaton masat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit	Ky funksion përfshinë respektimin e rregullave të sigurisë në punë, identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve në vendin e punës, mbrojtjen e shëndetit, dhënien e ndihmës së parë në rast të aksidenteve dhe ruajtjen e ambientit.
2	Përgatitë dhe organizon vendin e punës	Ky funksion përfshinë planifikimin dhe organizimin e vendit të punës me qëllim të realizimit të detyrave të punës .
3	Punimi dhe montimi i konstruksioneve metalike	Ky funksion ka të bëjë me punimin e pjesëve të konstruksioneve metalike me përpunim mekanik, bashkimin (mbërthimin) e pjesëve të konstruksioneve metalike dhe montimin e konstruksioneve metalike.
4	Kryen saldime të pjesëve metalike	Ky funksion përfshinë: saldimin e llamarinave, pllakave, profileve të ndryshme dhe gypave të çeliktë. Metodrat e saldimit janë standarde për pozicione të caktuara dhe për procese të veçanta të saldimit.
5	Përpunimi i pjesëve makinerike në makina tornuese konvencionale	Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e makinës tornuese konvencionale, përpunimin e pjesës makinerike në makina tornuese konvencionale dhe deponimin e pjesëve të përpunuara brenda vendit të punës
6	Përpunimi i pjesëve makinerike në makina shpuese konvencionale	Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e makinës shpuese konvencionale, përpunimin e pjesëve makinerike në makina shpuese, deponimin e pjesëve të përpunuara brenda vendit të punës
7	Përpunimi i pjesëve makinerike në makina frezuese konvencionale	Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e makinës frezuese konvencionale, përpunimin e pjesëve makinerike në makina frezuese, deponimin e pjesëve të përpunuara brenda vendit të punës
8	Operimi me makina CNC për prerjen dhe formësimin e llamarinave	Ky funksion ka të bëjë me operimin me makina CNC, për prerjen dhe formësimin e llamarinave, deponimin e pjesëve të punuara brenda vendit të punës.
9	Kontribuon në ngritjen e nivelit profesional	Ky funksion ka të bëjë me zhvillimin profesional: ngritja e vazhdueshme profesionale avancimi në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), dhe aktivitete lidhur me kalkulimin e shpenzimeve për produkte/procese.
10	Kryerja e llogarive për realizimin e punimeve metalpunuese	Ky funksion ka të bëjë me kalkulimin e shpenzimeve të materialit, kalkulimin e çmimit të produktit, kalkulimin e çmimit të finalizimit të produktit.

Funkcioni 1: Zbaton masat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit

Ky funksion konsiston në: respektimin e rregullave të sigurisë në punë, identifikimin dhe eliminimin e rreziqeve në vendin e punës, mbrojtjen e shëndetit, dhënien e ndihmës së parë në rast të aksidenteve dhe ruajtjen e ambientit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Kontribuon për një ambient të sigurt të punës dhe të shëndetshëm për punë	1. Monitoron hapësirat punuese dhe eviton shkaktarët e rrezikut, 2. Ndërmerr veprime konkrete në parandalimin e rasteve të rrezikshme, 3. Raporton për rreziqet e mundshme në vendin e punës 4. Zbaton rregullat për mbrojtje në punë me qëllim të sigurimit të shëndetit dhe ruajtjes së ambientit 5. Përdor pajisjet personale mbrojtëse	a) Përshkruan shkaktarët e rrezikut dhe mundësinë për evitim të tyre b) Shpjegon rëndësinë e përdorimit të mjeteve personale mbrojtëse c) Shpjegon shenjat e sigurisë në punë d) Përshkruan mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast të aksidenteve dhe lëndime në punë	- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë në mënyrë të sigurt, shfrytëzon në mënyrë racionale materialet dhe energjinë duke marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit. - Përdor mjetet personale mbrojtëse - Minimizon rrezikun e dëmtimit të pronës dhe pajisjeve - Bënë evakuimin e menjëhershëm në rast të aksidenteve - Menaxhon situatat në rast të aksidenteve - Zbaton mënyrat e dhënies së ndihmës së parë	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi
Kontribuon në evitim të aksidentet dhe ruajtjen e shëndetit	1. Identifikon shkaktarët e rrezikut në ambientin e punës 2. Evidenton lëndimet (aksidentet) në vendin e punës 3. Raporton për rastet e rrezikshme te personat përgjegjës	e) Rendit rastet e menaxhimit të situatave në rast të aksidenteve dhe lëndimeve në punë		

Ofron ndihmën e parë në rast të aksidenteve dhe lëndimeve	1. Ofron ndihmën e parë për të gjitha rastet e aksidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës			
---	--	--	--	--

Kushtet për realizimin e funksionit:

Mjetet e nevojshme: mjetet personale mbrojtëse dhe pajisjet për dhënien e ndihmës së parë

Kërkesat e vlerësimit:

Evidenca e përformancës: Dokumentimi i të dhënave (dëshmime) për aktivitetet e realizuara për zbatimin e masave të sigurisë në punë, bëhet përmes vëzhgimit të kandidatit.

Evidenca e njohurive: Test me shkrim dhe bashkëbisedim profesional për të demonstruar njohuri dhe shkathtësi për të zbatuar masat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së ambientit.

Funksioni 2: Përgatitë dhe organizon vendin e punës

Ky funksion konsiston në: planifikimin dhe organizimin e vendit të punës me qëllim të realizimit të detyrave të punës.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Përgatitë vendin e punës	Përgatitë vendin e punës në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret për ruajtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë Ndërmerr aktivitete të përshtatshme për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për punë Siguron të gjitha materialet e nevojshme për përdorim Siguron mjetet e sigurisë në rast të paraqitje së rrezikut dhe ndërprerjes së punëve Raporton mbi aktivitetet e kryera në linjë me procedurat e raportimit Ndërmerr hapat e kontrollit dhe zgjidhjes së problemeve dhe raporton për rastet të cilat nuk mund ti zgjidh	a) Përshkruan mënyrën e përgatitjes së vendit të punës dhe respektimin e rregullave të sigurisë në punë b) Shpjegon mënyrën e furnizimit dhe përzgjedhjes së materialeve të nevojshme për punë c) Shpjegon mënyrën e përdorimit të masave të sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit d) Tregon format e përgatitjes së raporteve të punës. e) Shpjegon rregullat e vizatimit teknik sipas standardeve. f) Përshkruan format e skicimit të pjesëve makinerike.	- Organizon detyrat ditore të punës bazuar në kriteret e përzgjedhura për realizim - Selektton dhe përzgjedhë materialet e përshtatshme bazuar në vetit dhe karakteristikat e procesit të prodhimit - Skicon pjesët, produktet dhe detajet e produkteve - Përgatitë veglat dhe makinat e nevojshme për procesin e prodhimit - Përgatitë raporte pune në linjë me procedurat e raportimit - Përdor veglat dhe mjetet e nevojshme për punë - Bënë kalkulime bazë të shpenzimeve ditore	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi
Përzgjedhë dhe klasifikon materialet e	Identifikon dhe përzgjedhë llojet e materialeve sipas formës, përbërjes fizike, kimike dhe kërkesave teknike			

nevojshme për punë	Klasifikon dhe sistemon materialet sipas specifikave dhe kërkesave për ruajtje të ambientit Përdor mjetet bazë për mbrojtje nga korrozioni Paketon dhe bënë ruajtjen e produktit final	g) Tregon mënyrën e përdorimit të veglave dhe pajisjeve për punë. Përshkruan procesin e mirëmbajtjes bazë për pajisjet dhe veglat e punës h) Shpjegon rëndësinë e saktësinë në punë në ndërlidhje me cilësinë e produktit. i) Tregon format e ruajtjes dhe paketimit të produktit final. j) Përshkruan mjetet bazë për mbrojtje nga korrozioni. k) Shpjegon mënyrën e përgatitjes dhe finalizimin e raporteve përfundimtare.	duke llogaritur koston e tyre - Bënë kontrollin e cilësisë së produkteve të realizuara - Përzgjedhë parametrat e nevojshëm për procesin e prodhimit - Përdorë mjetet për mbrojtjen dhe paketimin e materialeve - Mirëmban pajisjet dhe mjetet sipas manualeve dhe udhëzimeve të prodhuesit - Mirëmban mjedisin dhe ambientin e punës	
Riparon dhe mirëmban veglat dhe pajisjet e punës	Mirëmban veglat dhe pajisjet e punës Kontrollon dhe zgjidhë problemet sipas të dhënave në manualët e prodhuesit të makinës			

Kushtet për realizimin e funksionit:

Instruksonet e nevojshme: planifikimi i punës (fazat e punës/ kualiteti i punës) me qëllim të realizimit të aktiviteteve të përshkruar në funksion. Lista a mjeteve të nevojshme për punë, makinat, veglat, mjetet ndihmëse, siguria në punë dhe mbrojtja e ambientit.

Materialet e nevojshme: materiale, veglat, makina, instrumente matëse, material për lubrifikim, mjete ndihmëse, mjete mbrojtëse në punë.

Kërkesat e vlerësimit:

Dëshmi e përformancës: dëshmi për aktivitetet e realizuara, vlerësimi me listë kontrolli, vëzhgim i aktiviteteve të realizuara (përshkrimi detyrave të punës), demonstrimi praktik i një situatë reale pune.

Dëshmi e njohurive: test me shkrim, listë kontrolli, bashkëbisedë profesionale përmes demonstrimit të shkathtësive dhe njohurive profesionale për të kuptuar lidhjen në mes të aktiviteteve të realizuara sipas formës së përshkruar në funksion.

Funksioni 3: Punimi dhe montimi i konstruksioneve metalike

Ky funksion ka të bëjë me punimin e pjesëve të konstruksioneve metalike me përpunim mekanik, bashkimin (mbërthimin) e pjesëve të konstruksioneve metalike dhe montimin e konstruksioneve metalike.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Kryen punime të pjesëve të konstruksioneve metalike me përpunim mekanik	1. Bartë përmasat nga vizatimi konstruktiv në material me vegla dhe pajisje për vijëzim dhe shënim. 2. Përpunon sipërfaqet dhe tehet me lime. 3. Përpunon materialin me ndarje, këputje dhe prerje. 4. Formëson llamarinat, shufrat, gypat dhe profilet sipas kërkesave të vizatimit konstruktiv 5. Kryen shpim, zgjerim, lëshim dhe kalibrim të vrimave me pajisje dhe vegla përkatëse, 6. Hapë fileta me fileteprerës	a) Përshkruan llojet e pajisjeve dhe mjeteve për fiksime të pjesëve punuese, b) Shpjegon metodat e përpunimit: vijëzim, shënim, limim, ndarje, këputje dhe prerje. c) Përshkruan mënyrën e prerjes së teheve për shënim, vijëzim dhe ndarje. d) Shpjegon vizatimet konstruktive. e) Tregon instrumentet matëse dhe kontrolluese.	- Përdorë vegla dhe pajisjes për shtrëngim dhe fiksime - Kryen operacione përpunimi: vijëzim shënim, limim, ndarje, këputje, prerje dhe retifikim. - Mpreh instrumentet e vijëzimit dhe shënimit - Zbaton kërkesat e punës sipas dokumentacionit tekniko – teknologjik - Mate dhe kontrollon pjesën - Plotëson listën matëse.	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

	të dorës, 7. Përpunon pjesët me retifikuesen e dorës.			
Realizon bashkimin (mbërthimin) e pjesëve të konstruksioneve metalike	1. Realizon bashkimin e pjesëve me bulona dhe dado (lidhje të filetuar). 2. Realizon bashkimin e pjesëve me ribatina në mënyrë mekanike, 3. Bashkon pjesët me saldim 4. Pretë materialin me gaz 5. Poliron tegelat e salduar	a) Përshkruan specifikat e lidhjeve të ndashme dhe të pandashme të pjesëve. b) Përshkruan specifikat e lidhjeve të pjesëve me ribatinim manual dhe mekanik.	- Kryen lidhjen (bashkimin) e pjesëve me bulona dhe dado (lidhjet e filetuar) - Bashkon pjesët me ribatinim manual dhe mekanik - Bashkon pjesët me saldim	
Monton konstruksionet metalike	1. Bashkon pjesët e konstruksionit me lidhje të ndashme dhe të pandashme 2. Realizon dhe monton konstruksione axhusterike (dyer, dritare, porta, rrethoja, dhe shkallë metalike). 3. Riparon konstruksione axhusterike. 4. Realizon dhe monton konzola, trarë, shtylla, konstruksione të kulmeve, të urave dhe kapriatave. 5. Pastron sipërfaqet metalike me metoda mekanike, kimike dhe të kombinuara. 6. Realizon mbrojtjen	a) Përshkruan ecurinë e bashkimit të pjesëve të konstruksioneve metalike me lidhje të ndashme dhe të pandashme. b) Përshkruan ecurinë e procesit të punimit dhe montimit të elementeve të konstruksioneve axhusterike. c) Përshkruan ecurinë e procesit të ripunimit të konstruksioneve axhusterike. d) Përshkruan ecurinë e procesit të punimit dhe montimit të konzolave, trarëve, shtyllave,	- Bashkon pjesë të konstruksioneve metalike me lidhje të ndashme dhe të pandashme - Punon dhe monton elementet e konstruksioneve axhusterike (Metal, PVC) - Riparon konstruksionet axhusterike - Punon dhe monton konzola, trarë, shtylla, konstruksione kulmi, ura dhe kapriata. - Mbrojta sipërfaqësore (ngjyrosja) e pjesëve dhe konstruksioneve metalike	

	sipërfaqësore të pjesëve dhe konstruksioneve metalike (me ngjyrosje dhe veshje tjera metalike dhe jo-metalike).	konstruksioneve të kulmit, të urave dhe kapriatave. e) Përshkruan specifikat dhe ecurinë e procesit të mbrojtjes sipërfaqësor, të pjesëve, të konstruksioneve metalike, (me ngjyrë, mvëshje të tjera metalike dhe jo-metalike).		
Kontrollon cilësinë e punimeve axhusterike	1. Kontrollon saktësinë e operacioneve të kryera 2. Kontrollon dimensionet konform kërkesave të vizatimit konstruktiv. 3. Kontrollon pozitën dhe përmasat e vrimave, filetaturës se jashtme dhe te brendshme, 4. Kontrollon lidhjet e ndashme dhe të pandashme në konstruksionin metalik.	a) Përshkruan mënyrën e kontrollit të saktësisë dhe cilësisë të materialit bazë dhe ndihmës. b) Përshkruan mënyrën e kontrollit të saktësisë dimensionale dhe cilësisë se përpunimit të punimeve axhusterike c) Përshkruan mënyrën e përzgjedhjes se përmasave toleruese.	- Inspekton rregullsinë e gjendjes funksionale të makinës. - Kontrollon dimensionet konform kërkesave të vizatimit konstruktiv. - Kontrollon pozitën dhe përmasat e vrimave, filetaturës se jashtme dhe te brendshme, - Kontrollon lidhjet e ndashme dhe të pandashme në konstruksionin metalik.	

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës - Veglat kryesore të përpunimit axhusterik (Punimi dhe montimi i konstruksioneve metalike) përfshinë instrumente matëse me dorë (nonius, mikrometër, komparator, shirit matës, kalibra të ndryshëm dhe të tjera si tavolina pune, mengene, dara, kaçavida, çelësa formash dhe dimensionesh standarde për demontimin dhe montimin e pjesëve makinerike, kompresor, sharra mekanike, makine shpuese, ratifikuesja e dorës, filetprerësit, burgjitë spirale, pajisje për lakimin e profileve dhe llamarinave, aparate saldimi, ngjyra mbrojtëse, ngjyra bazike etj.

Kërkesat e vlerësimit: Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Evidenca/dëshmitë e performancës – Dëshmi se personi shqyrton vizatimin e punës, përzgjedhë makinat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e procesit të punimit dhe finalizimit të konstruksioneve metalik duke zgjedhur regjimin e duhur të punës, zgjedh instrumentet përkatëse prerëse dhe pajisjet e nevojshme për prerje dhe montim bazuar në vizatimet konstruktive të detajuara.

Dëshmitë e njohurive – Test me shkrim, demonstrim praktik i funksioneve dhe kriterëve të performancës, aktivitete gjatë orëve mësimore, etj.

Funksioni 4: Kryen saldime të pjesëve metalike

Ky funksion përfshinë: saldimin e llamarinave, pllakave, profileve të ndryshme dhe gypave të çeliktë. Metodat e saldimit janë standarde për pozicione të caktuara dhe për procese të veçanta të saldimit.

Aktivitetet kyçe (+ rezultatet e punës)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe të shoqëruara me funksionin kryesor
Realizon saldim me hark elektrik – HED	1. Organizon vendin e punës, përzgjedhë dhe përgatitë prodhimin dhe pajisjet ndihmëse, 2. Shqyrton vizatimin e punës, udhëzimet teknologjike ose specifikat e procedurave të saldimit (WPS). 3. Zgjedh mjetet e punës 4. Përzgjedh dhe rregullon pajisjet e saldimit me HED. 5. Përgatit dhe monton pjesët e tërësisë. 6. Kontrollon pjesët dhe montimin e tërësisë se salduar 7. Kontrollon cilësinë dhe riparimet e defektet e saldimit 8. Realizon saldimin manual (HED) dhe finalizon pjesët.	a) Përshkruan mënyrën e përzgjedhjes së elektrodave dhe materialeve të nevojshme për saldim me HED. b) Shpjegon pajisjet dhe veglat për saldim HED; c) Shpjegon parimin e saldimit me hark elektrik; d) Përshkruan shënimin e tegelit për saldim dhe materialeve themelore; e) Shpjegon terminologjinë e saldimit; f) Përshkruan specifikat e procedurës së saldimit (WPS), g) Përshkruan mënyrat e saldimit; h) Tregon simbolet e tegelit në vizatimet e punës;	- Saldon lidhjet këndore të pllakave të çelikut në pozicionet PA, PB, PC dhe PF dhe lidhjet ballore (të shtrira) në pozicionet PA, PC dhe PF. - Bën kontrollin vizuel dhe me instrumentet e duhura matëse të cilësisë së tegelit të salduar (poret, çarje, etj.). - Eliminon defektet e saldimit. - Përgatitë dhe bënë pastrimin e tërësive të gatshme, duke pastruar spërkatjet, skorjet, etj., nga sipërfaqet.	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

	9. Kryen kontrollin final të produktit të salduar. 10. Respekton rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit.	i) Shpjegon kërkesat e sigurisë (praktikat e duhura të punës, njohuritë themelore të ndihmës së parë, kërkesat themelore për mjedisin e punës, etj.); j) Shpjegon parimet e sistemit të cilësisë EN-3834 për punimet e salduara; k) Shpjegon standardet e kualifikimit të saldimit.		
Realizon saldim me elektrozistencë	1. Organizon vendin e punës, përzgjedhë dhe përgatitë prodhimin dhe pajisjet ndihmëse, 2. Shqyrton vizatimin e punës, udhëzimet teknologjike ose specifikat e procedurave të saldimit (WPS). 3. Zgjedh mjetet e punës 4. Përzgjedh dhe rregullon pajisjet e saldimit me elektrozistencë. 5. Përgatit dhe monton pjesët e tërësisë.	a) Përshkruan metodat për saldimin e pjesëve me elektrozistencë. b) Përshkruan mjetet dhe veglat e punës gjatë saldimit c) Tregon mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe veglave për saldim me elektrozistencë. d) Përshkruan teknikat e punës se saldimit me elektrozistencë	- Përdor pajisjet për saldim me elektrozistencë. - Përzgjedh elektrodën dhe materialet e nevojshme për saldim. - Zbaton regjimet përkatëse të saldimit me elektrozistencë - Kontrollon dhe eliminon gabimet në tegelat e salduar sipas standardit - Vendosi dhe kontrollon tërësinë për saldim - Bën testimin e saldimeve dhe	

	6. Kontrollon pjesët dhe montimin e tërësisë së salduar 7. Kontrollon cilësinë dhe riparon defektet e saldimit 8. Realizon saldimin me elektrozistencë dhe finalizon pjesët. 9. Kryen kontrollin final të produktit të salduar. 10. Respekton rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit.		verifikimin e montimit të tërësisë - Kontrollon produktin final pas saldimit	
Realizon saldim me gaz	1. Organizon vendin e punës, përzgjedhë dhe përgatitë prodhimin dhe pajisjet ndihmëse, 2. Shqyrton vizatimin e punës, udhëzimet teknologjike ose specifikat e procedurave të saldimit (WPS). 3. Zgjedh mjetet e punës 4. Përzgjedh dhe rregullon pajisjet e saldimit me gaz. 5. Përgatit dhe monton pjesët e tërësisë.	a) Tregon pajisjet për prerjen me gaz dhe përdorimin e tyre; b) Përshkruan metodat për saldimin me gaz dhe pajisjet e saldimit me gaz; c) Përshkruan parimin e saldimit me gaz; d) Tregon mënyrat e shënimit të tegelit për saldim dhe materialeve themelore; e) Shpjegon terminologjinë e saldimit;	- Përgatit pjesë për saldim - pastron dhe nëse është e nevojshme, - Përdor metoda të përshtatshme për fazat e salduara (p.sh. manuale, mekanike, termike). - Para-nxehet pjesët duke u bazuar në WPS dhe udhëzimet e punës - Kontrollon pjesët për t'u siguruar që ato përputhen me dimensionet e paraqitura në vizatimin e punës.	

	6. Kontrollon pjesët dhe montimin e tërësisë së salduar 7. Kontrollon cilësinë dhe riparon defektet e saldimit 8. Realizon saldimin me gaz dhe finalizon pjesët. 9. Kryen kontrollin final të produktit të salduar. 10. Respekton rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit.	f) Përshkruan specifikat e procedurës së saldimit(WPS), g) Tregon simbolet e tegelit në vizatimet e punës; h) Shpjegon kërkesat e sigurisë (praktikat e duhura të punës, njohuritë themelore të ndihmës së parë, kërkesat themelore për mjedisin e punës, etj.); i) Shpjegon parimet e sistemit të cilësisë EN-3834 për punimet e salduara; j) Shpjegon standardet e kualifikimit të saldimit.	- Prodhon dhe monton tersi duke u bazuar në vizatimin dhe udhëzimet e punës dhe WPS - Monton tërësitë sipas vizatimit të punës.	
Realizon saldimin me gazra aktive dhe inerte (MIG/MAG)	1. Organizon vendin e punës, përzgjedhë dhe përgatitë prodhimin dhe pajisjet ndihmëse, 2. Shqyrton vizatimin e punës, udhëzimet teknologjike ose specifikat e procedurave të saldimit (WPS). 3. Zgjedh mjetet e punës	a) Përshkruan mënyrën e përzgjedhjes së telit për metodën MIG/MAG b) Përshkruan pajisjet dhe veglat për saldim MIG/MAG; c) Përshkruan parimin e saldimit me MIG/MAG; d) Përshkruan karakteristikat, shenjat, trajtimin e gazrave të	- Saldon lidhjet këndore të pllakave të çelikut në pozicionet PA, PB, PC dhe PF dhe lidhjet ballore (te shtrira) në pozicionet PA, PC dhe PF. - Bën kontrollin vizuel dhe me instrumentet e duhura matëse të cilësisë së tegelit të	

	4. Përzgjedh dhe rregullon pajisjet e saldimit me MIG/MAG. 5. Përgatit dhe monton pjesët e tërësisë. 6. Kontrollon pjesët dhe montimin e tërësisë se salduar 7. Kontrollon cilësinë dhe riparon defektet e saldimit 8. Realizon saldimin MIG/MAG dhe finalizon pjesët. 9. Kryen kontrollin final të produktit të salduar. 10. Respekton rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit.	saldimit të përdorura në saldimin MIG/MAG; e) Shpjegon terminologjinë e saldimit; f) Përshkruan specifikat e procedurës së saldimit(WPS), g) Tregon simbolet e tegelit në vizatimet e punës; h) Përshkruan kërkesat e sigurisë (praktikat e duhura të punës, njohuritë themelore të ndihmës së parë, kërkesat themelore për mjedisin e punës, etj.); i) Shpjegon parimet e sistemit të cilësisë EN-3834 për punimet e salduara; j) Tregon standardet e kualifikimit të saldimit	salduar (poret, çarje, etj.). - Eliminon defektet e saldimit. - Përgatitë dhe bënë pastrimin e tërësive të gatshme, duke pastruar spërkatjet, skorjet, etj., nga sipërfaqet. - Pastron tegelat e salduar në çelikun INOX	
Realizon saldimin me metodën TIG	1. Organizon vendin e punës, përzgjedhë dhe përgatitë prodhimin dhe pajisjet ndihmëse, 2. Shqyrton vizatimin e punës, udhëzimet	a) Përshkruan mënyrën e përzgjedhjes së telit për metodën TIG b) Përshkruan pajisjet dhe veglat për saldimit TIG;	- Saldon lidhjet këndore të pllakave të çelikut në pozicionet PA, PB, PC dhe PF dhe lidhjet ballore (te shtrira) në pozicionet PA, PC dhe PF.	

	teknologjike ose specifikat e procedurave të saldimit (WPS). 3. Zgjedh mjetet e punës 4. Përzgjedh dhe rregullon pajisjet e saldimit me TIG. 5. Përgatit dhe monton pjesët e tërësisë. 6. Kontrollon pjesët dhe montimin e tërësisë se salduar 7. Kontrollon cilësinë dhe riparim defektet e saldimit 8. Realizon saldimit TIG dhe finalizon pjesët. 9. Kryen kontrollin final të produktit të salduar. 10. Respekton rregullat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit.	c) Përshkruan parimin e saldimit me TIG; d) Përshkruan karakteristikat, shenjat, trajtimin e gazrave të saldimit të përdorura në saldimit TIG; e) Shpjegon terminologjinë e saldimit; f) Përshkruan specifikat e procedurës së saldimit(WPS), g) Tregon simbolet e tegelit në vizatimet e punës; h) Përshkruan kërkesat e sigurisë (praktikat e duhura të punës, njohuritë themelore të ndihmës së parë, kërkesat themelore për mjedisin e punës, etj.); i) Shpjegon parimet e sistemit të cilësisë EN-3834 për punimet e salduara; j) Tregon standardet e kualifikimit të saldimit	- Bën kontrollin vizuel dhe me instrumentet e duhura matëse të cilësisë së tegelit të salduar (poret, çarje, etj.). - Eliminon defektet e saldimit. - Përgatitë dhe bënë pastrimin e tërësive të gatshme, duke pastruar spërkatjet, skorjet, etj., nga sipërfaqet.	
--	--	---	---	--

Kontrollon cilësinë e punës gjatë saldimit	1. Kontrollon cilësinë e materialit baze, shtese dhe ndihmës. 2. Kontrollon gjendjen e veglave dhe pajisjeve për saldim 3. Kontrollon gatishmërinë punuese të pajisjeve për saldim 4. Kryen kontrollin vizuel te formës dhe cilësisë se tegelit 5. Kontrollon depërtueshmërinë e tegelit, 6. Eliminon gabimet me metode përkatëse mekanike dhe me metode përkatëse saldimi.	a) Përshkruan mënyrën e kontrollit të cilësisë të materialit baze, shtesë dhe ndihmës. b) Përshkruan pajisjet dhe veglat përkatëse, c) Përshkruan mënyrën e kontrollit të rregullsisë dhe gatishmërisë punuese të pajisjeve, e) Përshkruan kontrollin dimesnional të tegelit, f) Përshkruan metodën e kontrollit të depërtueshmërisë se tegelit. g) Përshkruan metodën e eliminimit të gabimeve me metodën përkatëse mekanike dhe me metodën e saldimit.	- Zbaton metodat për kontrollin e cilësisë. - Bën kontrollin vizuel të cilësisë së tegelit të salduar. - Teston prova me shkatërrim (lakimi, Sharpi, tërheqja etj.). - Kontrollon tegelin me pajisjen e ultrazërit. - Identifikon formën dhe cilësinë e tegelit,	
--	--	---	--	--

Kushtet për realizimin e funksionit:

Identifikimi i nevojave:

Realizimi i saldimit të pjesëve bëhet varësisht nga lloji i materialit që do të saldohet për pozicione standarde të saldimit.

Instruksonet e nevojshme: përzgjedhja e materialeve dhe elektrodave të nevojshme për punë. Rregullimi i regjimit të saldimit, zbatimi i metodave standarde për saldim në pozicione të ndryshme dhe kontrollimi i tegeli të salduar.

Materialet e nevojshme: veglat dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e materialit, pajisjet për prerje, sharritje dhe retifikim, kompresor i ajrit, mjete personale mbrojtëse, maskë mbrojtëse, aparat saldimi elektrik, bombola autogjeni, bombola me gazë të ndryshëm për punë, material për mbushjen e tegelit të saldimit.

Kërkesat e vlerësimit:

Dëshmi e performancës: test me shkrim, listë kontrolli, bashkëbisedë profesionale përmes demonstrimit të shkathtësive dhe njohurive profesionale për të vlerësuar të arriturat sipas përshkrimit të funksionit. Vlerësim i tegelit të salduar pa thyerjes së pjesës.

DRAFT

Funksioni 5: Përpunimi i pjesëve makinerike në makina tornuese konvencionale

Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e makinës tornuese konvencionale, përpunimin e pjesës makinerike në makina tornuese konvencionale dhe deponimin e pjesëve të përpunuara brenda vendit të punës

Aktivitetet kyçe	Kriteret e Përformancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
Përgatit makinën tornuese konvencionale për përpunim	1. Lexon dhe shqyrton vizatimin e copës punuese. 2. Përcakton parametrat e makinës tornuese konvencionale për prodhimin e pjesëve punuese; 3. Fikson gjysmëfabrikatin në makinën tornuese duke zgjedhur regjimin e duhur të përpunimit. 4. Zgjedh instrumentet metalprerëse të nevojshme për prerje bazuar në vizatimin e detajuar dhe verifikon gjendjen e tyre. 5. Përcakton mënyrat optimale të prerjes 6. Përgatit makinën për punë duke u bazuar në	a) Përshkruan proceset teknologjike për përpunimin e pjesëve standarde; b) Tregon instrumentet prerëse të përdorura në tornim; c) Shpjegon makinat tornuese konvencionale, parimet e punës, strukturën dhe mënyrën e operimit; d) Shpjegon mënyrën e mirëmbajtjes së makinës tornuese konvencionale (lubrifikantët dhe ftohësit, filtrat, etj.); e) Tregon pajisjet e ndryshme, vendosjen dhe	- Përgatit vendin e punës - Siguron dokumentacionin teknologjik - Përgatit makinën - Përzgjedh instrumentet metalprerëse dhe pajisjet e punës - Monton dhe vendos instrumentet metalprerëse - Rregullon makinën sipas regjimit të përpunimit - Zbaton standardet e profesionit - Zbaton standardet dhe rregullat në punë dhe të ruajtjes së mjedisit	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

	vizatimin e detajuar, në gjysëmfabrikatin e dhënë dhe instrumentin metalprerës që duhet të përdoret.	fiksimi e instrumenteve prerëse; f) Përshkruan proceset teknologjike të makinës tornuese konvencionale; g) Tregon terminologjinë që ka të bëjë me tornimin (në gjuhën amtare dhe të paktën në një gjuhë të huaj).		
